

Raste lidhur me miratimin e dëmshpërblimit për ish të dënuarit politikë dhe trashëgimtarët e tyre

Seksioni i Veçantë ka si objekt të punës së tij, ndër të tjera, trajtimin e problematikave që lidhen me të persekutuarit dhe të drejtat e tyre.

Kështu, midis ankesave të ardhura në institucion gjatë vitit 2020, dy prej tyre kanë qenë të lidhura me mosmiratimin nga Këshilli i Ministrave të aktit nënligjor për dy aplikime, për të cilat kishte përfunduar shqyrtimi administrativ nga Ministria e Drejtësisë.

Për të dyja këto raste, u adresuan dy rekomandime drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, përkatësisht nr.K2/TH3-4 prot., datë 25.09.2020; K2/H10-4 prot., datë 30.12.2020¹ për dërgimin me përparësi për miratim në Këshillin e Ministrave të aktit nënligjor për aplikimet për dëmshpërblim të ish të dënuarve për të cilët ka përfunduar shqyrtimi administrativ nga kjo ministri.

Ministria e Drejtësisë i pranoi rekomandimet, përgatiti projektvendimin përkatës, i cili u miratua në Këshillin e Ministrave, konkretisht Vendimi nr.297, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e dëmshpërblimit financiar për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist”*.

1

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandohet%20d%C3%ABrgimi%20me%20p%C3%ABrpar%C3%ABsi%20p%C3%ABr%20miratim%20n%C3%AB%20K%C3%ABshillin%20e%20Ministrave%20i%20aktit%20n%C3%ABnligjor%20p%C3%ABr%20aplikimet%20p%C3%ABr%20d%C3%ABmshp%C3%ABrblim%20t%C3%AB%20ish%20t%C3%AB%20d%C3%ABnuarve%20politik%C3%AB.pdf>

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/rekomandim%20per%20te%20perndjekurit%20drejtuar%20MD.pdf>